

MIRË SE VINI NË ALPEX
KOMPANIA KOSOVARE PËR FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE – KESCO SHA

Me kënaqësi njoftojmë Anëtarësimin e Kompanisë Kosovare Për Furnizim Me Energji Elektrike – KESCO sh.a, Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike- ALPEX sh.a, për zonën ofertuese të Kosovës.

KESCO sh.a me selinë e saj të vendosur në Rrugën Bill Clinton, Prishtinë 10000, nënshkroi Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë më dt. 11.01.2024 dhe u bë Anëtar i ri i ALPEX në Tregun e Ditës në Avancë.

KESCO është themeluar në Janar të vitit 2015 dhe ka funksionin e Furnizuesit të Shërbimit Universal të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës.

Në rolin e Furnizuesit të Shërbimit Universal të energjisë elektrike, KESCO sh.a operon në Sektorin Elektroenergjetik të Kosovës duke përdorur teknikat më të mira bashkëkohore mbi furnizimin me energji elektrike për të gjithë konsumatorët e saj.

Kontakt

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike-ALPEX sh.a – Dega në Kosovë

Adresa: Rr. Ali Pashe Tepelena kati i II-te Nr.1 , VIP TOWER, Prishtinë, Kosovë.

Email: info@alpex.al